



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 3706 Prot.

Gramsh, më 26.09.2023

P/V E N D I M :

Nr. _____, datë ____/____/2023

PËR

DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR PUBLIK PËR NDËRTIM DHE OPERIM TË HEC-BLINETA, NGA SHOQËRIA "ERA HYDRO" shpk.

Keshilli Bashkiak Gramsh ne mbledhjen e tij te dates _____.____.2023, pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkise dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbështetur në ligjin nr.139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr.57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet", të Ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullor" i ndryshuar, në Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive" të ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacionit përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1374, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor", në Udhëzimin e Ministrit Mjedisit nr.01, datë 08.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik", Këshilli Bashkiak :

V E N D O S I :

1. Të shpreh dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullor publik, për ndërtimin dhe operimin e Hec-Blineta të sipërfaqjes prej 0.1304 ha, në ngastrat/nënngastrat pyjore nr.41/c (0.092 ha), nr.42/d (0.004 ha) të ekonomisë pyjore "Jançë-Kërpicë" për veprën e marrjes+dekantues dhe bazenin e presionit dhe nënngastra pyjore nr.19/b (0.0344 ha) të ekonomisë pyjore "Lubinjë-Tunjë" për ndërtimin e godinës së Hec-Blineta të Bashkisë Gramsh .

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë Bashkisë Gramsh.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT

XHULIA GJINI



KRYETARI I KËSHILLIT

ENIS ZANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 3500/prot

Gramsh, më 11.07.2023

P/V E N D I M

Nr. _____, Datë _____ 2023.

“PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA TË TOKAVE BUJQËSORE TË PANDARA”

Këshilli i Bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të Dt, _____ 2023 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, në zbatim të ligjit nr 8312 dt 26/03/1998 “Për tokat bujqësore të pandara” neni 5 i tij i ndryshuar, VKM nr.531 dat. 21/08/1998. “Për tokat bujqësore të pandara”, të ndryshuar, Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1 dt .18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, si dhe të ligjit nr. 139 dt. 17.12.2015.”Për vetqeverisjen vendore” neni 8, pika 2; neni 54,pika e, neni 9 pika 1.1 shkronja “b” “c”, neni 18 pika 1.

V E N D O S I

1. Të miratojë dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara në teritorin administrativ të Bashkisë Gramsh, sipas listës së mëposhtme;
- 2.

Nr	Nr.Pasurisë	Lloji Pasurisë	Sip.sipas kartelës m2	Statusi pronësisë	Njësia Administrative	Fshati	Zona Kadastrale
1	60/1	arë	3500	shtet	Kodovjat	Kodovjat	2188

2. Të zbatohen kriteret ligjore të përcaktuara në UKM nr.1 dt 18/07/2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave të paraqitura nga subjektet për marrjen me qira të tokës bujqësore.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe administrata e tij.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KESHILLIT

Xhulia GJINI

KRYETARI I KESHILLIT

Enis ZANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E SHËRBIMIT PYJOR, MJEDIST, MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Nr. 3706 Prot.

Gramsh, më 26.09.2023

Lënda : Relacion dhe dërgim dokumentacioni për një saktësimim në Vendimin e Këshillit Bashkiak Gramsh me nr.94, datë 27.11.2019 “Për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore në pronësi të Bashkisë Gramsh” për ndërtimin dhe operimin të Hec-Blineta nga Shoqëria “ERA HYDRO” shpk.

KËSHILLIT BASHKIAK

G R A M S H

Të nderuar Këshilltarë !


Bazuar në ligjin nr.139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në Ligjin nr.57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, të Ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor” i ndryshuar, në Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive” të ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacionit përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1374, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”, në Udhëzimin e Ministrit Mjedisit nr.01, datë 08.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak Gramsh me nr.94, datë 27.11.2019 “Për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore në pronësi të Bashkisë Gramsh” për ndërtimin dhe operimin e Hec-Blineta nga Shoqëria “ERA HYDRO”shpk dhe sipas shkresës së ardhur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me nr.4548/3 prot, datë 25.08.2023 “Mbi dërgimin e dokumentacionit për ndërtimin e Hec “Blineta” të protokolluar me NR.RRGJ. 3251, datë 28.08.2023 pranë Bashkisë Gramsh, lidhur me specifikimet për ngastrat/nënngastrat pyjore e

kullosore, ekonomitë pyjore dhe kullosore si dhe llojin e aktivitetit për të cilin do të miratohet heqja nga fondi pyjor dhe kullosor për ndërtimin dhe operimin e Hec-Blineta nga shoqëria "ERA HYDRO"shpk, kërkohet që nga Këshilli Bashkiak Gramsh të bëhet një saktësim dhe të specifikohen të dhënat e duhura sipas draftit të ri (model) të dërguar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, pasi në Vendimin e Këshillit Bashkiak Gramsh nr.94, datë 27.11.2019 nuk janë paraqitur numëri i ngastrave/nënngastrave pyjore e kullosore dhe ekonomitë pyjore/kullosore që preken në projektin e ndërtimit dhe operimin e Hec-Blineta.

Bashkëngjitur këtij relacioni do të jetë kopje të shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me nr.4548/3 prot, datë 25.08.2023 "Mbi dërgimin e dokumentacionit për ndërtimin e Hec "Blineta" draftin e ri (model) për sipërfaqen do të hiqet nga fondi pyjor e kullosor, projekt-vendimin ku janë saktësuar lloji i aktivitetit që do të kryhet si dhe numëri i ngastrave/nënngastrave pyjore/kullosore, ekonomitë pyjore/kullosore me sipërfaqet përkatëse, një kopje të Vendimin e Këshillit Bashkiak Gramsh me nr.94, datë 27.11.2019 "Për vazhdimin e proçedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor publik të sipërfaqeve pyjore/kullosore në pronësi të Bashkisë Gramsh" për ndërtimin dhe operimin e Hec-Blineta nga Shoqëria "ERA HYDRO"shpk, si dhe kopje të shkresës nr.1758/1prot, datë 31.12.2019 "Konfirmim akti" nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

KRYETARI

Besion AJAZI





BASHKIA GRAMSH

Mërriti me Datë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIMIN E MJEDISIT
DREJTORIA E NATYRËS DHE PYJEVE

2023.08.25

Nr. 4548/prot.
3

Tiranë, më 25.08.2023

Lënda: Mbi dërgimin e dokumentacionit për ndërtimin e Hec "Blineta"

BASHKISË GRAMSH

Sheshi "Kamber Dërmyshi", Bulevardi "10 Korriku", GRAMSH

Në vijim të shkresës suaj nr. 2817/1 prot., datë 9.08.2023 "Dërgim informacioni mbi raportin tekniko-ekonomik", lidhur me ndërtimin e Hec "Blineta", në bashkinë Gramsh, Ju informojmë se:

Bazuar në V.K.M. nr.591 dhe 592, datë 9.10.2018, pika 2/b, në funksion të qartësisë dhe shmangies së interpretimeve, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ka kërkuar që Vendimi i Këshillit Bashkiak të përmbajë specifikimet me ngastrat pyjore/kullosore dhe ekonominë pyjore/kullosore, si dhe aktivitetin për të cilin miratohet heqja nga fondi pyjor, sipas draftit të dërguar me shkresë zyrtare.

Vendimi i Këshillit Bashkiak të Gramshit, nr. 94, datë 27.11.2019, nuk përmban asnjë informacion kadastral se ku hiqet sipërfaqja prej 0.1896 ha, në çfarë ngastre, të kujt ekonomie, për të bërë të mundur ndryshimet kadastrale, pas miratimit të heqjes së kësaj sipërfaqe të përfshirë në këtë vendim të këshillit bashkiak.

Për sa më sipër, mbetemi në pritje të qartësimin të këtij dokumenti.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

Arslan - Drejtor

Lek. Adm - Muxhalli

D. Blendi - Kollçaku dhe J. M. Balla

Të pranishmit: Alkess


... për ...

... bashkiak

... me ...

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

DEJDA BEQIRAJ AGALLIU



23-08-2023

Arslan



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

Draft

V E N D I M

NR. _____, Datë _____, _____, 2023

Për dhënien e dakortësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/ kulloror publik për (vendoset lloji i aktivitetit për të cilin merret vendimi).....nga shoqëria.....(emri i shoqërisë)

Bazuar në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore". Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Per funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014 datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020, datë 30.04.2020 "Për Pyjet", në Ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë". në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. _____ datë _____ "Për transferimin në pronësi të bashkive të fondit pyjor e kulloror publik" në VKM nr. 888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", në VKM nr. 1374, 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kulloror" Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr.1. datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kulloror publik", Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kulloror publik për (lloji i aktivitetit për të cilin merret vendimi)....., të sipërfaqes prej (sa është në tabelën përmbledhëse të raportit teknik) Ha, në ngastrën(numri i ngastrës dhe nëngastrës), në ekonominë (emertimi i ekonomisë pyjore/kullorore), të bashkisë
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet (emërtesa e strukturës përgjegjëse për pyjet në bashki)
3. Ky vendim hyn në fuqi (sipas akteve tuaja)

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

.....
(emër Mbiemër, Firmë)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 7268 / Prot.
2

Gramsh, më 13 . 12 . 2019

V E N D I M
Nr. 94, datë 27 . 11 . 2019
PËR

**VAZHDIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR TË
SIPËRFAQEVE PYJORE DHE KULLOSORE NË PRONËSI TË BASHKISË
GRAMSH.**

Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës 27 . 11.2019, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari I Bashkisë dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor mbështetur në KPA në Republikën e Shqipërisë: të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 3 gërma ç, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1/ b, neni 23/4, si dhe neni 54 gërma "k", të ligjit nr.9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" I ndryshuar, të ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullorosor" I ndryshuar, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.591, datë 09.10.2018 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.1353, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave e të zvogëlimit të sipërfaqes e të vellimit të fondit pyjor "të ndryshuar (Pika 2, gërma b), në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.592, datë 09.10.2018 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.1374, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullorosor", të ndryshuar (Pika 2, gërma b), të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas lista vetë inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive", si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr.01, datë 08.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullorosor publik", Pika 22, 23, dhe 24:

V E N D O S I :

1. Të miratojë vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore prej 0.1304 ha ha ,për veprën e marrjes + dekantues,bazeni i presionit dhe godina e

Hec-it Blineta,që do ndërtohet nga shoqëria "ERA HYDRO"sh.p.k,fond pyjor/kullosor që ndodhet në territorin administrativ të Bashkisë Gramsh.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë dhe Drejtorja e Shërbimit Pyjor si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë Bashkisë Gramsh.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT

ENDRI MEMA



KRYETARI I KËSHILLIT

GRETA LENA



Dr. Sh. Pyllar
Sek. Këshillit

08.01.2020



BASHKIA GRAMSH
NR REJJI 7268/2
Mbërriti me Date 08.01.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 1758/prot.
1

Elbasan, më 31.12 2019

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK GRAMSH

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.94 datë 27.11.2019 "Për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor të sipërfaqeve pyjore e kullosore në pronësi të Bashkisë Gramsh", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI



Maksim Malaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH

DREJTORIA E SHËRBIMIT PYJOR, BUJQËSISË, MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Nr 3500 prot

Gramsh, më 11.09. 2023

RELACION

“PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA TË TOKAVE BUJQËSORE TË PANDARA”

Të përgjithshme

Në kuptim të ligjit nr. 8312 datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”:

Tokë është pjesa e sipërme e kores së tokës, që përfshinë lëndë minerale, lëndë organike, pjesën e lëngshme, pjesën e gaztë dhe pjesën biotike.

Tokë bujqësore, është sipërfaqja e tokës që si e tillë figuronë në regjistrat kadastral të shtetit , e zënë me bimët e arave, pemishte, vresht dhe ullishte, kudo ndodhur dhe që ka veçori thelbësore të saj pjellorinë.

Qëllimi:

Dhënia në përdorim e tokave bujqësore të pandara siguron jo vetëm fitim ekonomik rritje të ardhurash, rritje të punësimit por edhe garantimin e mbrojtjes së tokës bujqësore, pasi çdo subjekt qiramarrës i ngarkohet detyrë që ta mirmbajë dhe të sigurojë stabilitet dhe qëndrueshmëri ndaj tokës bujqësore.

Autoritetet shtetërore dhe strukturat pranë tyre, të cilat kanë detyrime dhe përgjegjësi për mbrojtjen e tokës bujqësore janë;

- a; Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit,
- b; Komiteti Shtetëror i Mbrojtjes së Tokës (KSRMT),
- c; Drejtoria Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.
- ç; Këshilli i Qarkut,
- d; Kryetari i Këshillit të Qarkut,
- dh; Komisioni i Mbrojtjes së tokës (KMT) në Qark,
- e; Inspektori i Mbrojtjes në Qark (IMT) .
- ë; Këshilli i Bashkisë,
- f; Kryetari i Bashkisë,

Në bazë të udhëzimit të Këshillit të ministrave nr. 1. Dt.18.07.2012, Sektori i menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (SMMT), në Bashki dhe Njësitë Administrative në vartësi të Bashkisë, evidentojnë sipërfaqet e tokës bujqësore për dhënie me qira, duke pasqyruar numrin kadastral të ngastrave, madhësinë në hektarë, si dhe vendndodhjen e tyre dhe i paraqet Këshillit të Bashkisë i cili shqyrton dhe miraton sipërfaqet e tokave bujqësore, që mund të jepen me qira.

Kryetari i bashkisë në cilësinë e autoritetit qiradhënës, krijon Komisionin e Qiradhënies së Tokës Bujqësore të Pandarë (KQTBP).

KQTBP-ja ka në përbërje

- | | |
|---|---------|
| - Kryetarin e bashkisë | kryetar |
| - Një përfaqësues të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë | anëtar |
| - Një përfaqësues i DAMT në Qark | anëtar; |
| - Një specialist të ZMMT-së në Bashki | anëtar; |

- Nje specialist jurist në Bashki;

anëtar

Kryetari i Bashkisë në cilësinë e autoritetit Qiradhënës, ka për detyrë:

a . Shqyrtimin e kërkesave të paraqitura nga subjektet për marrjen me qira të tokës, si dhe marrjen e vendimit nga komisioni, brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim;

b . Organizimin e procedurës së garës, si dhe garantimin e barazisë për subjektet pjesmarrëse, kur për të njëjtën tokë bujqësore është paraqitur më shumë se një kërkesë për qiramarrje;

c . Shpalljen dhe njoftimin e vendimit të marrë për qiradhënie pranë bashkisë ose Njesisë administrative ku ndodhet toka bujqësore;objekt i qiradhënies;

d . Lidhja e kontratës tip me subjektin e përzgjedhur;

Kërkesa për marrjen me qira të tokës bujqësore,objekt i këtij udhëzimi mund të bëhet nga çdo person fizik dhe juridik, vendas ose i huaj.

Toka bujqësore, objekt i këtij udhëzimi,jepet me qira vetëm në rastet e shfrytëzimit të saj për veprimtari bujqësore ku vërtetohet me anë të projekteve bujqësore që subjektet kanë si detyrim ti paraqesin ato.

Pasi janë bërë verifikimet e dokumentacionit përkatës, nga Sektori i Bujqësisë, pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor në Bashkinë Gramsh, në kordinim me Njësitë Administrative në vartësi të Bashkisë dhe ZVRPP Gramsh,vëren se sipërfaqja e tokës bujqësore është e pandarë , e cila duke qënë objekt i udhëzimit të mësipërm kërkohet të jepet me qira, sipas procedurave të udhëzimit të këshillit të Ministrave.

Lista e tokave bujqësore të pandara në teritorin e Bashkisë Gramsh, të cilat i propozojmë Këshillit të Bashkisë për dhënien me qira është si me poshtë;

Nr	Nr.Pasurisë	Lloji I pasurisë	Sip. Sipas karteles m2	Statusi i pronësisë	Njësia Administrative	Fshati	Zona Kadastrale
1	60/1	arë	3500	shtet	Kodovjat	Kodovjat	2188

Sa më lartë , është në kompetencën e këshillit të bashkisë marrja e vendimit për dhënien me qira të tokës bujqësore duke ju referuar pikës 2 të udhëzimit dhe më pas është komisioni i Qiradhënies së tokës Bujqësore të Pandarë(KQTPB) që grumbullon kërkesat, nëse ka,shpall procedurat e garës(ankandin) dhe më pas nxjerr vendimin përfundimtar të pa anshëm deri në lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin fitues.

Specialisti i Bujqësisë

Qamile Kullolli



KRYETARI
Besion AJAZI